



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 31
Prishtinë, më 06 nëntor 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Qeraniq, Mërgim Lushtaku, Valon Ramadani, Albert Kinolli, Emilija Rexhepi dhe Ali Lajçi.

Munguan: Avdullah Hoti, Andin Hoti, Etem Arifi dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Antigona Ibraj, Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rustemi.

I ftuar: Kujtim Gashi, ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Veton Frizi, sekretar i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ismet Krasniqi, sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës.

Pjesëmarrësit e tjerë: Samir Hoxha, Zamira Ahmeti nga MKRS, Vjoleta Smajlaj, Astrit Bllaca dhe Emine Fazliu nga ZKA-ja, Erëblina Ajaz nga Kuvendi i Kosovës, Isa Vatovci nga Kallxo.com dhe Egzon Murturi nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.10.2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.10.2018

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 24.10.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Valon Ramadani tha që Zyra Kombëtare ka dhënë opinion të kundërt me theksim të çështjes. Ai tha që bazë për dhënien e opinionit ishin: llogaritë bankare të institucioneve vartëse që janë në bankat komerciale, menaxhohen nga drejtorët dhe nuk janë të autorizuara nga thesari. Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK) dhe MKRS kanë kompensuar punëtorët profesionalë dhe punëtorët ndihmës në terren, të angazhuar në realizimin e projekteve të trashëgimisë kulturore në vlerë 526,730€, sipas rregullores nr. 01/2009 për pagesën e punëtorëve në terren, e cila është shfuqizuar me vendim të Qeverisë. Projekte të pa arsyeuara me dokumente mbështetëse nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në vlerë 1,843,534€. MKRS me qëllim të realizimit të 30 projekteve ka kryer pagesa në vlerë 1,175,026€, mirëpo pagesat e tilla janë certifikuar në mungesë të dokumentacionit përcjellës. Te të hyrat ai tha që MKRS nuk ka plan për inkasimin e të hyrave. Te menaxhimi i personelit ai tha që MKRS gjatë vitit kishte angazhuar 104 persona me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta dhe 14 prej tyre janë marrë pa procedura të rekrutimit. Ai gjithashtu tha që parregullsi kishte edhe në kategorinë për mallrat dhe shërbimet, në kategorinë për investime kapitale, si dhe në kategorinë e subvencioneve. Për auditimin e brendshëm ai tha që auditori ka gjetur se drejtori i NJAB-ës raporton te sekretari i Përgjithshëm, përderisa me ligjin e AB dhe kornizën e qeverisjes së mirë kjo përbën konflikt interesi.

Kujtim Gashi tha që pozitën e ministrit e ka marrë në shtator të vitit 2017. Ai pranoi që janë lidhur memorandume më shumë se sa ka pasur mjete të planifikuar. Gjithashtu tha që gjatë vitit 2018 nuk ka asnjë person, nuk është angazhuar pa i përfillur procedurat e rekrutimit. Ai tha që federatat aktualisht financohen sipas rregullores për subvencione. Pagesat të cilat kanë ndodhur në para kesh nuk janë duke ndodhur më me mbylljen e xhirollogarive. Sa i përket stadiumit të qytetit ai tha që ky është rast i veçantë ku është dashur të respektohen kriteret e UEFA-ës. Auditori i brendshëm ai tha që tani i raporton ministrit.

Emilija Rexhepi tha që ne, si komunitet i pakicave, e kemi pasur mbështetjen edhe nga ministri i kaluar, por edhe nga ministri i tanishëm, sidomos për një projekt për Qendrën e Kulturës për komunitetet pakicë në Prizren. Ajo pyeti se si është punësimi i komuniteteve pakicë dhe sa është numri i të punësuarve të komunitetit boshnjak.

Driton Selmanaj pyeti se pse ka ndodhur që sekretari të lidhë memorandume të bashkëpunimit me 27 Federata Sportive, kurse Rregullorja e Qeverisë thotë që këtë mund ta bëjë vetëm ministri. Ai tha që

ministrria ka shkelur procedurat gjatë rregullimit të Stadiumit të Prishtinës. Një fillim është nënshkruar një kontratë 380 mijë euro dhe më pas është nënshkruar një kontratë tjetër në vlerë prej 4.4 milionë euro. Ai gjithashtu pyeti ministrin për pagesat e parregullta, më konkretisht pagesat shtesë për anëtarët e komisioneve e cila bie në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Z. Selmanaj parashtroj pyetje për sekretarin se pse drejtori i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Gjakovë është paguar për 5 vite pa kontratë.

Veton Frizi tha që lidhja e memorandumeve është bërë me autorizim të ministrit, por që ai nuk ka qenë me shkrim. Ai tha që çështja e Stadiumit të Prishtinës është një çështje e veçantë. Për shkak të kërkesave specifike të UEFA-së është dashur të paguajmë pa procedurë të shpallur, por që çdo herë ata kanë lajmëruar KRPP-në. Ai për pagesat e parregullta tha që bëhet për komisionet për çështje specifike.

Driton Selmanaj tha që ka qenë fenomen që pagesat të bëhen pagesat në para kesh. Ai tha që kjo sigurisht ka qenë edhe në vitet e kaluara. Ai potencoi që Ministria kishte lëshuar edhe para në llogari private dhe nuk dihej qëllimi i subvencionimit. Kjo kishte ndodhur në dy raste. Një herë te një OJQ dhe një herë tjetër te një biznes. Z. Selmanaj pyeti pse auditori i Brendshëm i ka raportuar sekretarit të Përgjithshëm, e që sipas ligjit kjo përbënë konflikt interesi.

Veton Frizi tha që numri total i punëtorëve të rinj është rreth 20 dhe të gjithë janë marrë sipas procedurave të parapara. Ai për çështjen pagesat e mëvonshme tha se ka raste kur federatat bëjnë pagesat me mjete vetanake në garat e ndryshme, pastaj ministria detyrohet t'i paguajë mjetet më vonë. Ai gjithashtu tha që disa institucione kanë lëshuar mëditje nga fondet e projekteve të tyre sipas një rregullore e cila nuk ishte nënshkruar nga ministri. Z. Frizi tha se që nga viti 2007 ministria ka bërë denoncimin e 1100 OJQ-ve të cilat nuk e kanë mbyllur me kohë projektin e tyre të subvencionuar.

Mërgim Lushtaku tha që duhet të përcaktohet saktë se kush ka drejtë të miratojë rregullore dhe që ministri duhet të nënshkruajë çdo rregullore në kuadër të ministrisë përkatëse.

Albert Kinolli tha çështja e Stadiumit të Prishtinës është mirë që ka ndodhur sepse më në fund kemi stadiumin tonë, mirëpo që në asnjë mënyrë nuk justifikohen shkeljet. Ai tha që beson që ministri do të punojë që këto shkelje të cilat i ka gjetur auditori të përmirësohen dhe në vitin e ardhshëm të kemi një raport më të mirë për këtë ministri.

Driton Selmanaj tha ky është një nga raportet më të këqija që ai ka lexuar deri më tani dhe tha që beson që kjo nuk duhet të shkojë vetëm me përgjegjësi politike.

Emilija Rexhepi tha që ky raport të adresohet për në seancë plenare, por pyeti se çka mund të ndërmarrim tutje në mënyrë që të përcjellim implementimin e rekomandimeve sepse në të kundërtën kjo i bie që komisioni nuk po kryen sa duhet punën e tij dhe nuk po arrin ta mbikëqyrë punën e ekzekutivit.

Përfundim

KMFP vendosi që në mbledhjen e radhës së komisionit të merr vendim për raportin e auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 së bashku me rekomandimet.

4. Të ndryshme.

Driton Selmanaj njoftoi deputetët që lidhur me çështjen e auditimit të parive politike është prezent sekretari i Kuvendit të cilit edhe ia dha fjalën.

Ismet Krasniqi tha se prezenca e tij lidhet me kërkesën e komisionit për të dhënë një sqarim për proceduat e tenderimit për auditimin e partive politike. Ai tha që nga zyra e prokurimit ka pranuar një shkresë nga e cila tregon që ka një çmimore të publikuar në web-faqen e KRPP-së në vitin 2015 dhe në atë çmimore nuk ka asgjë rreth auditimit të partive politike, pra nuk kemi të dhëna se sa mund të kushtojë një aktivitet i tillë. Ai tha që ka ardhur të marrë një pëlqim nga komisioni sepse po rezulton që shumica prej 30.000 euro nuk janë të mjaftueshme dhe si administratë të mund të bëjnë transfere të mjeteve shitesë.

Mërgim Lushtaku tha që është vullnet i komisionit që të shtyjme këtë çështje përpara. Ai tha që administrata është ajo që do të duhej të merret më këtë çështje dhe jo të lihet në dorë të deputetëve të përcaktohet kjo shumë sepse kjo nuk është çështje politike, po është çështje profesionale.

Përfundim

KMFP vendosi që Administrata ta përgatitë një propozim se si e shoh zgjidhjen e çështjes së mjeteve shitesë për auditimin të raporteve financiare dhe të atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitin 2017.

Kryetari i komisionit lexoi para anëtarëve të KMFP-së rekomandimet në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për vitin 2017.

Përfundim

KMFP, miratoi rekomandimet lidhur me Raportin e auditimit të PVF-ve për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për vitin 2017, mirëpo vendosi që ky Raport të mos e adresohet për seancë plenare, por rekomandimet të adresohen te MPMS.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj